



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>DPKI</u>	Nr Prot Br Prot <u>06-01/1276/22</u>
Nr 11aq Broj stranice <u>03</u>	Date Datum <u>22.03.2022</u>



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 22.03.2022, mori:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me nr. *AKK-DPK-06-138/22*, për zyrtarin e lartë z. Arben Vishaj, Drejtor i Klinikës Infektive në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

## A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokollit AKK-DPK- 06-138/22, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Arben Vishaj, Drejtor i Klinikës Infektive në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, është zhvilluar procedura e paraparë për trajtimin e situatave të konfliktit të Interesit.

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare pas raportimit nga jashtë më të cilën është ngritur dyshimi se Drejtor i Klinikës Infektive në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, z. Arben Vishaj, është pronar i një ordinancë private.

Sipas procedurës Agjencia fillimisht ka marrë informacione nga ARBK (Agjencia Për Regjistrimin e Bizneseve), ku është identifikuar se zyrtari Arben Vishaj, figuron të jetë Pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat me emër N.SH "Infeksioni"

Pas konfirmimit të informacionit Agjencia kundër Korrupsionit sipas procedurës së paraparë, fillimisht e ka njoftuar zyrtarin e lartë me një shkresë zyrtare për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas pranimit të kësaj shkrese, është mbajtur takim me zyrtarin e lartë dhe është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mund të ushtroj edhe funksion menaxhues në biznesin privat, sepse kjo është e ndaluar me neni 13 (paragrafi 1) të Ligjit nr.06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit, në të cilën thuhet:

1. *Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit.*

Ndërsa me nenin 19 të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit parashihen masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave. Dispozitat e nenit në fjalë përcaktojnë se:

1. *Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave:*
  - 1.1. *transferon interesin privat dhe të drejtat në drejtimin e ndërmarrjes sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji; [...];*
  - 1.3. *jep dorëheqjen nga detyrat, funksionet ose veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin e tij publik;*
  - 1.4. *dorëhiqet nga funksioni publik.*

Pas këtij takimi me zyrtarin e lartë të quajtur ndryshe edhe si ballafaqim i fakteve, zyrtari i lartë z. Arben Vishaj, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se nuk ka pas njohuri në lidhje me kufizimet e parapara, me gjithë atë do të ndërmerr veprime të menjëhershme në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrim të funksionit publik.

Në ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin, informacionin zyrtar nga z. Arben Vishaj, Drejtor i Klinikës Infektive në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, me të cilën na ka njoftuar se ka ndërmarr veprimet e nevojshme dhe ka hequr dorë nga të që nurit person i autorizuar në biznesin privat me emër N.SH “Infeksioni” .

Agjencia kundër Korrupsionit, konstaton se me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, z. Arben Vishaj, Drejtor i Klinikës Infektive në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, duke hequr dorë nga të që nurit person i autorizuar në biznesin privat me emër N.SH “Infeksioni”, janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.




II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll Buleshkaj  
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Yll Buleshkaj". Below the signature is a circular official stamp in blue ink. The text inside the stamp reads "AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT" at the top and "KOSOVË" at the bottom.